

# EPOKA

# ERE

E përditshme e pavarur  
Viti XXIII, nr. 6920  
E martë, 13 qershor 2023  
Çmimi 0.40 €

Mavraj: Pa kufi nderime dëshmorëve, luftëtarëve dhe mirënjohje pa kufi për strategët e lirisë në Hagë! | FAQE 3



Na ndiqni edhe në:

[www.epokaere.com](http://www.epokaere.com)

facebook.com  
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH  
[www.awr-abbruch.de](http://www.awr-abbruch.de)

KOSOVA SHPREH MIRËNJOHJE PËR 24 VJET LIRI | FAQE 4-5

## DITA E ÇLIRIMIT, NJË NDËR DATAT MË TË RËNDËSISHME NË HISTORINË E POPULLIT TË KOSOVËS



Në shënimin e 24-vjetorit të Ditës së Çlirimit, në kuadër të agjendës shtetërore, presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, por edhe anëtarë të kabinetit

qeveritar, kanë bërë homazhe pranë varrit të ish-presidentit Ibrahim Rugova, veprimtarit Adem Demaçi dhe familjes Jashari në Prekaz, gjithashtu kanë bërë nderime te pllaka përkujtimore e ushtarëve të

rënë të NATO-s gjatë shërbimit në operacionin e KFOR-it në Kosovë. Udhëheqësit e shtetit Ditën e Çlirimit të Kosovës e kanë vlerësuar një ndër datat më të rëndësishme në historinë e popullit të Kosovës

### OPINION

12 QERSHORI - DITA E ÇLIRIMTARËVE TË KOSOVËS | F.7

Lulëzim ETEMAJ



### AKTUALE



VDES ISH-KRYEMINISTRI ITALIAN SILVIO BERLUSCONI | F.2

PDK-ja E FTON KURTIN NË INTERPELANCË PËR RASTIN E AMBASADORIT MARTIN BERISHAJ | F.7


### EKONOMI



MINISTRIA E INFRASTRUKTURËS SHPALL FITUESIT E TENDERIT PËR ZGJERIMIN E RRUGËS PRISHTINË -PODUJEVË | F.8

PSE BIZNESET PO VAZHDOJNË T'I RRRITIN ÇMIMET? | F.8

### SPORT



SEFERI: JAM GATI PËR KOMBËTAREN, TA MARRIM MAKSIMUMIN | F.12

**NJOHËSI I ÇËSHTJEVE TË EMERGJENCAVE: INSTITUCIONET PËRGJEGJËSE T'I RRRITIN KAPACITETET NË RAST TË PËRMBYTJEVE TË MUNDSHME** | FAQE 7



**SITUATA NË VERI, LAJÇAKU: TENSIONET JANË ENDE TË LARTA** | FAQE 3



**RENOVA**  
PUTZ  
Macedoni  
Xhepçisht -Tetovë  
Gurëz-Ferizaj  
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009  
+389 44 487 755  
Fax: +389 44 487 200  
Mob: +377 44 501 289  
E-mail: [renova@mt.net.mk](mailto:renova@mt.net.mk)

**PRINCESHA**  
GROUP SH.P.K.  
NDËRTIM  
PROJEKTIM  
SHITJE  
INFO: 049-111-101,  
044-511-177  
[www.princesha-ks.com](http://www.princesha-ks.com)

**Bunjamini**  
FABRIKA E LLAQEVE  
MITROVICË  
044/256-051  
044/367-061  
028/532-617  
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

**Kolegji BIZNESI**  
[www.kolegji.biznesi.com](http://www.kolegji.biznesi.com)  
info@kolegji.biznesi.com  
030 500 878 | 045 500 878  
044 500 878 | 049 500 878

**SIGMA**  
VIENNA INSURANCE GROUP  
SIGMA INTERBALKANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A  
DEGA KOSOVË  
Rruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,  
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,  
E-mail: [info@sigma-ks.net](mailto:info@sigma-ks.net) | [www.sigma-ks.net](http://www.sigma-ks.net)

**INFINITY**  
Digital Agency  
Endrit Shaqiri  
+38344685122  
Internet Website,  
Marketing...



# Vdes ish-kryeministri italian Silvio Berlusconi

ROMË, 12 QERSHOR - Ish-kryeministri italian Silvio Berlusconi ka vdekur në moshën 86-vjeçare. Ish-kryeministri italian ka ndërruar jetë në spitalin San Raffaele në Milano, raportojnë mediet italiane. Ai ishte një afarist miliarder që krijoi kompaninë më të madhe mediatike të Italisë përpara se ta transformonte peizazhin politik të vend.

Berlusconi e ka formësuar jetën politike italiane për disa dekada. Ai arriti të rikthehej në skenën politike italiane nga skandalet seksuale dhe akuzat për korrupsion.

Popullisti i krahut të djathtë, ka

qenë kryeministër katër herë, me disa pauza, prej vitit 1994 deri më 2011. Ai udhëhoqi partinë e qendrës së djathtë Forza Italia, e cila hyri në koalicion nën kryeministrin Giorgia Meloni pas zgjedhjeve në shtator të vitit 2022, kur ai u zgjodh vetë në Dhomën e Lartë të Italisë, Senat.

Berlusconi ka pasur probleme shëndetësore vite me radhë. Në prill ai u trajtua për një infeksion të mushkërive të lidhur me një rast të pazbuluar më parë të leukemisë kronike.

Në fund të vitit 2020 ai është infektuar me koronavirus, ndërsa më 2016 i është nënshtruar një operimi në zemër.



## ShBA-ja vendos të rikthehet në UNESCO pas 10 vjetësh

UASHINGTON, 12 QERSHOR - Agjencia kulturore dhe shkencore e OKB-së, UNESCO, njoftoi të hënën se Shtetet e Bashkuara planifikojnë të rikthehen në këtë agjenci dhe të paguajnë më shumë se 600 milionë dollarë detyrime të prapambetura - pas një mosmarrëveshjeje dhjetëvjeçare të shkaktuar nga masa e organizatës për të përfshirë Palestinën si anëtare.

Zyrtarët amerikanë thanë se vendimi për t'u kthyer ishte i motivuar nga shqetësimi se Kina po plotëson boshllëkun e lënë nga ShBA-ja në politikëbërjen e UNESCO-s, veçanërisht në vendosjen e standardeve për inteligjencën artificiale dhe edukimin teknologjik në mbarë botën.

Zëvendëssekretari amerikan i Shtetit për Menaxhimin dhe Burimet, Richard Verma, i dërgoi një letër javën e kaluar drejtorit të përgjithshëm të UNESCO-s, Audrey Azoulay, duke zyrtarizuar planin për t'u ribashkuar.

Duartrokitjet shpërthyen në auditorin solemn të UNESCO-s teksa Azoulay i njoftoi ambasadorët për planin në një



takim të posaçëm të hënën, dhe delegatët u ngritën për ta mirëpritur lajmin.

Kthimi i ShBA-së, dikur financuesja më e madhe e agjencisë, pritet të përballet me një votim nga 193 shtetet e saj anëtare muajin e ardhshëm, sipas një diplomati të UNESCO-s.

Vendimi është një nxitje e madhe financiare për Organizatën e

Kombeve të Bashkuara për Arsim, Shkencë dhe Kulturë, e njohur për programin e saj të trashëgimisë botërore, si dhe për projektet për t'i luftuar ndryshimet klimatike dhe për t'i mësuar vajzat shkrimlexim.

ShBA-ja dhe Izraeli ndaluan financimin e UNESCO-s pasi ajo votoi për përfshirjen e Palestinës si shtet anëtar më 2011 dhe të dyja

vendet humbën të drejtat e tyre të votës më 2013.

Administrata Trump vendosi në vitin 2017 të tërhiqej krejtësisht nga agjencia.

Në letrën e tij javën e kaluar, Verma vuri në dukje përpjekjet e UNESCO-s drejt reformës së menaxhimit dhe "uljes së debatit të politizuar, veçanërisht për çështjet e Lindjes së Mesme".

Që nga zgjedhja e saj më 2017, Azoulay ka punuar për t'i adresuar arsyet e largimit të ShBA-së përmes reformave buxhetore dhe ndërtimit të konsensusit midis diplomatëve jordanezë, palestinezë dhe izraelitë rreth rezolutave të ndjeshme të UNESCO-s.

Vendimi i ShBA-së për t'u rikthyer "është rezultat i pesë viteve të punës, gjatë së cilës ne qetësuam tensionet, veçanërisht në Lindjen e Mesme, përmirësuam përgjigjen tonë ndaj sfidave bashkëkohore, rifilluam nismat kryesore në terren dhe modernizuam funksionimin e organizatës", tha Azoulay për "Associated Press".

Sipas planit, qeveria amerikane do t'i paguajë detyrimet e saj për vitin 2023 plus 10 milionë dollarë

kontribute bonus këtë vit të destinuar për edukimin e Holokaustit, ruajtjen e trashëgimisë kulturore në Ukrainë, sigurinë e gazetarëve dhe edukimin shkencor dhe teknologjik në Afrikë, thuhet në letrën e shkruar nga Richard Verma.

Administrata Biden ka kërkuar tashmë 150 milionë dollarë për buxhetin e vitit 2024 për t'i paguar detyrimet e prapambetura të UNESCO-s.

Plani parashikon kërkesa të ngjashme për vitet në vijim derisa të shlyhet borxhi i plotë prej 619 milionë dollarësh. Kjo përbën një pjesë të madhe të buxhetit operativ vjetor prej 534 milionë dollarësh të UNESCO-s.

Përpara largimit, ShBA-ja kontribuoi me 22 % të financimit të përgjithshëm të agjencisë.

Shtetet e Bashkuara u tërhoqën edhe më parë nga UNESCO nën administrimin e presidentit Regan në vitin 1984 sepse e shihnin agjencinë si të keqmenaxhuar, të korruptuar dhe të përdorur për t'i çuar përpara interesat sovjetike.

ShBA-ja iu ribashkua organizatës në vitin 2003.

## Lëvizja Evropa Tani fiton zgjedhjet në Mal të Zi, DPS-ja e dyta

PODGORICË, 12 QERSHOR - Lëvizja Evropa Tani (PES) e Malit të Zi fitoi 26 % të votave në zgjedhjet e parakohshme parlamentare të 11 qershorit (24 mandate), sipas rezultateve preliminare të Qendrës për Monitorim dhe Kërkim (CEMI). Partia pro-evropiane Demokratike e Socialistëve (DPS), e cila e udhëhoqi Malin e Zi midis viteve 1990 dhe 2020, doli e dyta me 23.8 % të votave (21 mandate).

Aleanca konservatore për të Ardhmen e Malit të Zi, e

udhëhequr nga Fronti Demokratik pro-serb dhe pro-rus, fitoi 14.7 % (13 mandate). Sondazhet para votimeve ishin të përafërta me rezultatet preliminare.

Sipas CEMI-t, një koalicion tjetër pro-BE-së që përfshin Partinë Demokratike dhe Lëvizjen URA të kryeministrit në largim, Dritan Abazović, doli në vendin e katërt me 12.3 % të votave (11 mandate).

Millojko Spajiq, lider i listës së Lëvizjes Evropa Tani (PES), në fjalimin e tij të parë

paszgjedhor, deklaroi se ishte një fitore e madhe për partinë e tij, e cila, nga një parti joparlamentare, u shndërrua në partinë më të madhe në Mal të Zi, për më pak se një vit. "Ne presim që qeveria të formohet sa më shpejt. Do të flasim me të gjithë ata që kanë vlera si tonat. Ne do të formojmë një qeveri të re pro-evropiane", ka thënë Spajiq.

Për 81 ulëset e Parlamentit të Malit të Zi garuan 15 parti dhe koalicione. Të drejtë vote kishin 542 468 qytetarë.





# Mavraj: Pa kufi nderime dëshmorëve, luftëtarëve dhe mirënjohje pa kufi për strategët e lirisë në Hagë!

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Për nder të 12 Qershorit - Ditës së Çlirimit, publicisti Muhamet Mavraj u ka shprehur nderime pa kufi dëshmorëve dhe luftëtarëve të UÇK-së si dhe mirënjohje pa kufi strategëve të lirisë në Hagë. Ai ka shkruar në "Facebook" se shtylla kurrizore jona është dashuria pa hile për lirinë dhe kulmimi i miqësisë shqiptaro-

amerikane e nisur 110 vjet më herët nga lobet tona historike. Mavraj në këtë datë të çlirimit ka theksuar se pa amerikanët nuk ka prosperitet e siguri as Evropa e lëre më kombi shqiptar. "Kushdo që me retorika boshe patriotike po na i pret degët nën këmbë, ky trung do ta ngufasë. Interesi i kombit do të mbijetojë, mbi gjithçka!", ka shkruar Mavraj.

## KOMENTI I PLOTË I MAVRAJ:

24 vjet liri e Kosovës.

Kjo ndikoi pozitivisht edhe për shqiptarët në Kosovën Lindore, në Maqedoni e Mal të Zi. Shqipëria mori krahë dhe lum për të. Shtylla kurrizore jona është dashuria pa hile për lirinë dhe

kulmimi i miqësisë shqiptaro-amerikane e nisur 110 vjet më herët nga lobet tona historike. Pse? Sepse pa amerikanët nuk ka prosperitet e siguri as Evropa e lëre më kombi shqiptar. Kushdo që me retorika boshe patriotike po na i pret degët nën këmbë, ky trung do ta ngufasë. Interesi i kombit do të mbijetojë,

mbi gjithçka!

Por, pse fituam 24 vjet më parë? Sepse luftëtarët fitimtarë fitojnë së pari dhe pastaj shkojnë në luftë, ndërsa luftëtarët e mundur shkojnë së pari në luftë dhe pastaj përpiqen të fitojnë, qysh thonë kokat e urta ndër shekuj. Pa kufi nderime dëshmorëve, luftëtarëve dhe mirënjohje pa kufi për strategët e lirisë në Hagë!



## Situata në veri, Lajçaku: Tensionet janë ende të larta

PRISHTINË, 12 QERSHOR - I dërguari i posaçëm i Bashkimit Evropian për dialogun në mes të Kosovës dhe Serbisë, Miroslav Lajçak, tha se "tensionet janë ende të larta" mes dy vendeve, teksa shtoi se ai dhe emisari amerikan Gabriel Escobar kanë "shpresuar për më shumë" rezultate gjatë vizitës së tyre në Beograd dhe Prishtinë. Qëllimi i udhëtimit të tyre ishte adresimi i situatës së tensionuar në veri të Kosovës dhe eksplorimi i mundësive për një zgjidhje politike.

Në rrjete sociale, Lajçaku tha se ata shprehën shqetësimet e tyre për situatën e krijuar dhe theksuan urgjencën për shtensionim të situatës. Bashkimi Evropian dhe Shtetet e Bashkuara të Amerikës, përveç shtensionimit të menjëhershëm, u kanë kërkuar zgjedhje të parakohshme në veri, me



pjesëmarrjen e serbëve që jetojnë në atë pjesë të Kosovës dhe kthimin e palëve në dialog për normalizim të raporteve. Këto pika u përsëritën gjatë takimeve të tyre me udhëheqësit e Kosovës dhe Serbisë. "Pas një ndalesë të shkurtër në Takimin Vjetor të Këshillit Evropian për

Marrëdhëniet me Jashtë në Stokholm, ku pata rastin të bisedoj me një numër njerëzish nga Evropa dhe ShBA-ja, tani jam kthyer në Bruksel për ta informuar BE-në dhe Shtetet Anëtare mbi gjetjet e mia dhe hapat e ardhshëm. Ne vazhdojmë përpjekjet tona për

të mundësuar dhe mbështetur një zgjidhje të qëndrueshme politike", ka shkruar Lajçak. Një ditë më parë Escobari tha se ShBA-ja është e angazhuar ta ndihmojë Kosovën ashtu edhe Serbinë për integrimin e tyre në Bashkimin Evropian. Escobar foli edhe për marrëveshjen që Kosova dhe Serbia arritën në Ohër të Maqedonisë së Veriut në muajin mars të këtij viti. Implementimi i kësaj marrëveshjeje, sipas Escobarit, i hap rrugë një "marrëdhënie paqësore dhe konstruktive" në mes të Kosovës dhe Serbisë. "Ne duhet të gjejmë një mënyrë për t'i depërshkallëzuar proceset menjëherë, për ta depërshkallëzuar situatën dhe menjëherë të kthehemi në fokusin e zbatimit të Marrëveshjes së Ohrit", theksoi

Escobar. Sipas tij, për Serbinë kjo do të thoshte dhënie fund bllokimit të integritetit evropian dhe ndërkombëtar të Kosovës dhe për Kosovën kjo do të nënkuptonte fillimin e procesit të zbatimit të Asociacionit të Komunave me Shumicë Serbe. "Duhet të punojmë menjëherë për të dyja gjërat", tha Escobar. Dy javët e fundit raportet në mes të Kosovës dhe Serbisë janë tensionuar sërish pasi në katër komunat veriore janë duke u zhvilluar protesta nga grupe të serbëve lokalë të cilët po kundërshtojnë futjen në objektet komunale të kryetarëve të rinj të Mitrovicës së Veriut, Zveçanit, Zubin Potokut dhe Leposaviqit. Tensionet kulmuam më 29 maj, kur në Zveçan grupe të maskuara të serbëve lënduan 30 ushtarë të KFOR-it, tre prej tyre me armë zjarri.

## Të mërkurën në Gjakovë mbahet mbledhja e përbashkët e dy qeverive Kosovë - Shqipëri

Prishtinë, 12 qershor - Të mërkurën në Gjakovë do të mbahet mbledhja e përbashkët e Qeverisë së

Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Republikës së Shqipërisë. Lajmi është dhënë nga Zyra për Informim e

Qeverisë së Kosovës. Qeveritë e të dyja shteteve janë pajtuar të mbajnë mbledhje të përbashkëta për

vendosje të "një partneriteti strategjik më të strukturuar dhe të institucionalizuar në mes të dy vendeve".







KOSOVA SHPREH MIRËNJOHJE PËR 24 VJET LIRI

# Dita e Çlirimit, një ndër datat më të rëndësishme në historinë e popullit të Kosovës

Në shënimin e 24-vjetorit të Ditës së Çlirimit, në kuadër të agjendës shtetërore, presidentja Vjosa Osmani, kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca, kryeministri Albin Kurti, por edhe anëtarë të kabinetit qeveritar, kanë bërë homazhe pranë varrit të ish-presidentit Ibrahim Rugova, veprimtarit Adem Demaçi dhe familjes Jashari në Prekaz, gjithashtu kanë bërë nderime te pllaka përkujtimore e ushtarëve të rënë të NATO-s gjatë shërbimit në operacionin e KFOR-it në Kosovë. Udhëheqësit e shtetit Ditën e Çlirimit të Kosovës e kanë vlerësuar një ndër datat më të rëndësishme në historinë e popullit të Kosovës

**EPOKA ERE****Mal QORRAJ**

**PRISHTINË, 12 QERSHOR** - Kosova të hënën ka shënuar 24-vjetorin e Ditës e Lirisë apo Çlirimit të Kosovës, kur trupat paqeruajtëse të NATO-s hynë në Kosovë pas fushatës ajrore të Aleancës së Veri-Atlantikut kundër caqeve ushtarake dhe policore serbe në Kosovë dhe Serbi.

Presidentja e vendit, Vjosa Osmani, e shoqëruar nga kryetari i Kuvendit, Glauk Konjufca dhe kryeministri Albin Kurti, kanë vënë kurora me lule nëpër disa lokacione në Prishtinë gjatë kësaj dite, duke i nderuar figurat politike, aktivistët dhe ushtarët e rënë të NATO-s në Kosovë. Ata bënë homazhe te varri i ish-presidentit Ibrahim Rugova dhe te

varri i veprimtarit të çështjes kombëtare, Adem Demaçi. Tre udhëheqësit shtetërorë homazhet i vazhduan në Kompleksin Memorial "Adem Jashari" në Prekaz dhe te pllaka përkujtimore

për ushtarët e rënë të NATO-s. Presidentja Osmani ka thënë se sot shënojmë përvjetorin e një prej ditëve të rëndësishme në historinë e kombit tonë, një prej ditëve më të rëndësishme në

historinë e Republikës së Kosovës. "Sot shënojmë përvjetorin e një prej ditëve të rëndësishme në historinë e kombit tonë, një prej ditëve më të rëndësishme në historinë e Republikës së Kosovës, ditën kur shteti ynë u çlirua, pas një lufte e cila rezultoi me gjenocid ndaj një populli të pafajshëm, popullit të Republikës së Kosovës", ka thënë Osmani.

Presidentja Osmani ka thënë se sot nderuam ata që i vënë themelet e forta të shtetit që e gëzojmë sot. "Në mëngjes ne sot nderuam vizionarët e shtetit tonë, nderuam dëshmorët e shtetit tonë, nderuam ata që i vënë

themelet e forta të shtetit që e gëzojmë sot, dhe tani këtu nderojmë ushtarët e NATO-s, ata që nga 10 qershori e tutje hynë në Republikën e Kosovës për t'ia dhënë vulën çlirimit të vendit tonë", ka theksuar ajo.

Më tej, presidentja Osmani ka thënë se jemi mirënjohës përherë për të gjithë ata që vendosën themelet e shtetit tonë. "Jemi mirënjohës përherë dhe e përsëritim këtë mirënjohje në emër të të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës, siç e thashë, për vizionarët e shtetit, për presidentin Rugova, gjithë aktivistët që dhanë gjithçka që të





# 12 Qershori - Dita e Çlirimtarëve të Kosovës



Lulëzim ETEMAJ

24 vjet më parë, në ditën e 78-të të sulmeve ajrore të NATO-s kundër forcave ushtarake dhe objekteve strategjike të Serbisë, në mbrëmjen e 9 qershorit 1999 në Kumanovë u nënshkrua Marrëveshja Teknike-Ushtarake. Millosheviqi dhe qeveria e tij, tanimë me barrën e rënduar të genocidit dhe krimeve të luftës në shpinë, pranuan kapitullimin në Kosovë. Ish-sekretari gjeneral i NATO-s, Javier Solana, me këtë

rast shprehet prerazi: "NATO do t'i suspendojë sulmet ajrore sa më shpejt që të verifikohet respektimi i armëpushimit dhe fillimi i tërheqjes së forcave ushtarake serbe".

Kështu "mbaroj një luftë e cila ishte e drejtuar kundër vlerave perëndimore dhe civilizimit evropian... Mbaroj një luftë e cila me siguri Kosovën do ta kishte zbratur nga popullata e saj autoktone shqiptare dhe do t'i kishte destabilizuar të gjitha vendet fqinje", shkruan në ditarin e tij ish-ministri gjerman i mbrojtjes, Rudolf Scharping. Për t'u përballur me situatën e pas tërheqjes së trupave ushtarake, policore dhe paraushtarake serbe nga Kosova, ministrat e mbrojtjes të vendeve anëtare të NATO-s pasdite arritën



pëlqimin dhe u dhanë dritën e gjelbër trupave paqësore ndërkombëtare, KFOR. Më 10 qershor 1999 Këshilli i Sigurimit i OKB-së aprovon dërgimin e trupave të KFOR-it në Kosovë dhe e ngarkon OKB-në, përmes Rezolutës 1244, për ndërtimin e administratës së përkohshme vendore. Më 12 qershor fillon marshimi i trupave paqësore ndërkombëtare në Kosovë. Një pjesë e trupave gjermane, të vendosura në Maqedoni, stacionohet në kufi me Shqipërinë, ndërsa një numër i tyre së bashku me amerikanët dhe britanikët përmes Shkupit marshojnë në Prishtinë. Të tjerët përmes rrugëve të vështira malore të Shqipërisë arrijnë në Prizren. Aeroporti i Prishtinës tanimë ishte futur nën kontrollin e forcave ruse, që ishin të stacionuara në Bosnjë në përbërje të SFOR-it, të cilat kishin filluar marshimin në

Kosovë natën. Ushtarët e Aleancës së NATO-s, ashtu si dhe ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës, u pritën nga qytetarët shqiptarë të Kosovës si çlirimtarë: me duartrokitje, buqeta lulësh, përqafime e lot gëzimi e shprese në sy. Trupat paqësore ndërkombëtare, në përpjekje të krijimit të rendit dhe qetësisë, shënojnë kontakte të ngushta me komandantët e UÇK-së. Ndërsa refugjatët shqiptarë të Kosovës, të strehuar me zemërgjerësi shembullore në Shqipëri, si dhe ata në Maqedoni, s'mund t'i ndalë asgjë, as vërejtjet për rreziqet nga fushat e minuara përgjatë brezit kufitar, për t'u kthyer sa më parë në shtëpitë e tyre prej nga i kishte dëbuar dhuna serbe. Për t'u kthyer në Kosovën e lirë. Tashmë kishte aguar dita e re, dita e parë e epokës së shumëpritur ndër breza nga shqiptarët e epokës së lirisë së Kosovës.

vendosen këto themele, për komandantin legjendar Adem Jashari dhe të gjithë ushtarët e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës që vënë jetën e tyre në rrezik, dhanë jetën e tyre për lirinë tonë. Por, edhe mirënjohje e përjetshme për të gjithë miqtë tanë, të cilët na ndihmuan që lirinë, pavarësinë dhe demokracinë ta kemi realitet të cilin sot e gëzojmë të gjithë qytetarët e Kosovës", ka theksuar Osmani.

Duke e vlerësuar 12 qershorin e vitit 1999 si ditën më të çmuar për popullin e Kosovës, kryetari Konjufca ka theksuar se çlirimi i Kosovës është shembulli më i spikatur i bashkëveprimit të suksesshëm mes faktorit vendor dhe bashkësisë ndërkombëtare. "Për ne ishte dita e ardhjes së lirisë. Një datë shumë e çmuar për popullin e Kosovës, po ashtu edhe sukses i madh në planin ndërkombëtar, sepse Dita e Çlirimit të Kosovës koincideoi pikërisht edhe me ndaljen e genocidit të Serbisë ndaj popullit të Kosovës", ka deklaruar Konjufca.

Kreu i Kuvendit potencoi ndihmën e pakursyer të shteteve

mike për çlirimin e vendit. "Kjo ndodhi pikërisht sepse kauza jonë ishte shumë e drejtë. Krejt çfarë po kërkonim si popull ishte ta hiqnim okupimin serb shekullor nga Kosova", është shprehur Konjufca. Kryetari i Kuvendit ka thënë se meritoret për lirinë e Kosovës janë dëshmorët dhe martirët që u flijuan, si dhe sakrificat e popullit për ta arritur këtë ditë. "Ata do të kujtohen dhe nderohen gjithmonë sepse janë në themelet e lirisë së shtetit tonë", ka deklaruar kreu i Kuvendit.

Kryeministri Kurti ka thënë se sot përkujtojmë dhe festojmë 24-vjetorin e çlirimit të Kosovës dhe vendosjen e paqes në vendin tonë, pra 12 Qershorin. "Bashkë me presidenten e Republikës dhe kryetarin e Kuvendit i kujtuam duke vendosur lule të freskëta dhe duke bërë homazhe për humanizmin e Rugovës, qëndresën e Demaçit, sakrificën e Jasharëve dhe, këtu, kontributin e NATO-s. Përulemi para gjithë dëshmorëve dhe martirëve të kombit dhe të gjithë atyre të cilët dhanë jetën për lirinë e popullit dhe çlirimin e Kosovës. Ndërhyrja ushtarake e NATO-s e ndaloi

genocidin e Serbisë mbi popullin tonë. Gjithnjë dhe përgjithmonë u jemi falënderues dhe mirënjohës", ka thënë Kurti.

Ditën e Çlirimit e kanë uruar edhe liderët e partive opozitare, duke theksuar se për këto 24 vjet në liri, Kosova është ndërtuar e është zhvilluar jashtëzakonisht shumë, ndoshta më shumë se secili vend në rajon për të njëjtën periudhë kohore.

Fushata bombarduese e NATO-s, që zgjati 78 ditë, përfundoi më 10 qershor 1999, pas miratimit të Rezolutës 1244 të Këshillit të Sigurimit të Organizatës së Kombeve të Bashkuara (OKB), me kapitullimin e Serbisë dhe tërheqjen e forcave të saj nga Kosova.

Rezoluta 1244 e OKB-së në Kosovë vendosi administratën e përkohshme të OKB-së, UNMIK, për ta administruar vendin e shkatërruar nga lufta, për një periudhë tranzitore deri në ngritjen e kapaciteteve vendore dhe zgjidhjen e statusit të Kosovës. Ajo, po ashtu, siguroi bazën ligjore për vendosjen e 50 000 trupave paqësorësh të udhëhequra nga NATO për ta siguruar paqen në

Kosovë, njëherësh edhe misionin në i madh paqeruajtës i Aleancës veriatlantike.

Vendosjes së trupave paqeruajtëse i parapriu Marrëveshja Teknike e Kumanovës, që parashihte tërheqjen e të gjitha forcave serbe nga Kosova dhe hyrjen e trupave ndërkombëtare të NATO-s në Kosovë.

Tërheqja e plotë e trupave serbe përfundoi më 20 qershor 1999.

Ushtarët e parë që u futën brenda territorit të Kosovës më 1999 ishin pjesëtarë të ushtrisë norvegjeze. Ata ishin pjesë e forcave paqeruajtëse nga 36 vende të botës - prej të cilëve 30 000 ishin të shteteve të NATO-s që erdhën në Kosovë.

Me hyrjen e trupave ndërkombëtare u mundësua kthimi në shtëpitë e tyre të mbi 800 000 refugjatëve, persona të zhvendosur brenda dhe jashtë Kosovës, të dëbuar nga shtëpitë e tyre, që po strehoheshin në kampe në Shqipëri dhe Maqedoni të Veriut.

Ndërhyrja ushtarake e NATO-s erdhi pas gati një dekade përpjekjesh diplomatike ndërkombëtare për t'i ndaluar

luftërat në ish-Jugosllavi. Në Kosovë asaj i parapriu konferenca e Rambujesë dhe e Parisit, ku Serbia refuzoi kompromisin që ta ndalte dhunën e forcave të saj në Kosovë.

Në luftën e viteve 1998-'99 janë vrarë më shumë se 13 000 persona dhe më shumë se 6 000 të pagjetur. Qindra shqiptarë të vrarë nga Kosova janë gjetur në varreza masive në Serbi. Trupat e tyre janë bartur nga forcat serbe me qëllim që të fshihen krimet.

Udhëheqësit politikë dhe ushtarakë të Serbisë janë arrestuar, gjykuar dhe dënuar nga Gjykata Ndërkombëtare e Hagës për ish-Jugosllavi për krimet kundër njerëzimit të kryera në Kosovë. Ndër ta ishte edhe Slobodan Millosheviqi i cili vdiq në burg pa arritur të dënohet për përgjegjësinë në urdhërimin e krimeve të luftës në Kosovë. Sipas të dhënave, mbi 1 600 persona konsiderohen ende të pagjetur.

Njëzet e tre vjet pas hyrjes në Kosovë, numri i trupave të KFOR-it është zvogëluar. Aktualisht në vend janë mbi 4 000 trupa nga 28 shtete të botës.



## Drejtorët e drejtorive komunale i raportojnë kryetarit Latifi



**RAHOVEC, 12 QERSHOR** - Kryetari i komunës së Rahovecit, Smajl Latifi, ka mbajtur të hënën takimin e rregullt me drejtorët e drejtorive komunale.

Mbledhja ka filluar me raportimin mujor të zyrarit përgjegjës për Zbatimin e Planit të Integritetit në komunën e Rahovecit, Valmir Gashi.

Gjatë diskutimeve, secila drejtori veç e veç si dhe shefi i Zyrës për Komunitete dhe Kthim, Lendrit Qeli, raportuan për punët e javës që shkoi dhe

fokusi ishte në punët që do të zhvillohen gjatë muajit qershor, ecurinë e tyre dhe zgjidhjen e problematikave të mundshme gjatë procesit të punës.

## Në Gjilan përurohet murali 'Forca e Gruas'

**Gjilan, 12 qershor** - Në Gjilan është përuarur të hënën murali madhështor 'Forca e Gruas', një projekt ky që promovon gjithë përfshirjen, përkatësisht është thirrje për një çështje që qëndron në thelb të shoqërisë, ndërgjegjësimin për familje të barabarta.

Projekti është mbështetur nga zyra e kryetarit të komunës së Gjilanit, Alban Hyseni, i cili ka marrë pjesë në këtë përuarim. Drejtori i Drejtorisë për Kulturë, Rini e Sport në komunën e Gjilanit, Kushtrim Zeqiri, në emër të kryetarit të komunës, ka falënderuar Mural Fest Kosova që ka realizuar në Gjilan këtë vepër, që promovon në rend të parë respekt dhe barazi. "Ne jemi të hapur gjithmonë si komunë

për të përkrahur projekte që përcjellin mesazhe të tilla për qytetarët tanë", ka thënë Zeqiri. Murali 'Forca e Gruas' shërben si një kujtesë e fuqishme e forcës, qëndrueshmërisë dhe dashurisë që nënat sjellin në familjet dhe komunitetin e tyre.

Visare Mujko-Nimani, shefe e Zyrës së Fondit të Kombeve të Bashkuara për Popullsinë në Kosovë (UNFPA), ka theksuar se ky është murali i parë që është përkrahur nga zyra e tyre në kuadër të disa të tillëve që do të bëhen nëpër qytete të ndryshme të vendit.

Murali përmban një mesazh të qartë për promovimin e barazisë gjinore, fuqizimin e grave dhe politikave më miqësore për familjen.



## 11 raste të dhunës në familje në rajonin e Ferizajt për një javë



**FERIZAJ, 12 QERSHOR**- Në Policinë Rajonale të Ferizajt gjatë javës së kaluar, nga data 05-11/06/2023, janë raportuar 11 raste të dhunës në familje, prej tyre 8 raste në Ferizaj, 2 raste në Kaçanik dhe 1 rast në Shtërpçë. Me vendim nga Prokuroria

Themelore në Ferizaj, pesë persona janë ndaluar në mbajtje për 48 orë, ndërsa 6 persona të tjerë të dyshuar janë liruar për procedurë të rregullt hetimore.

Policia Rajonale e Ferizajt rastet e dhunës në familje i ka trajtuar

në mënyrë profesionale nga policë primare të stacioneve dhe hetues rajonale të Njësisë së Dhunës në Familje. Policia u bën thirrje qytetarëve t'i raportojnë rastet e dhunës në familje dhe i fton qytetarët të bashkëpunojnë me policinë.

## Totaj së bashku me kryetarin e qytetit turk Edirne nderojnë dëshmorët në Prizren

**PRIZREN, 12 QERSHOR** - Në 24-vjetorin e Çlirimit të Prizrenit, kryetari Shaqir Totaj, së bashku me kryetarin e qytetit turk Edirne, i binjakëzuar me Prizrenin, Recep Gürkan, zyrtarë komunalë, përfaqësues të familjeve të dëshmorëve dhe shoqatave të dala nga lufta e UÇK-së, kanë bërë homazhe në Varrezat e Dëshmorëve në

Landovicë. "Dëshmorët e kombit kanë vendin më të veçantë në historinë e lavdishme të Kosovës, të cilët dhanë më të shtrenjtën, jetën, për liri. Kjo ditë na kujton sakrificën e popullit dhe organizimin e jashtëzakonshëm politik e ushtarak të vajzave dhe djemve tanë. Ju kujtojmë përherë. Lavdi!", u shpreh kryetari Totaj.



## Numër i vogël i serbëve vazhdojnë protestat në veri

**Mitrovicë, 12 qershor** - Serbët edhe të hënën janë mbledhur para ndërtesave të komunave në Leposaviq, Zvečan dhe Zubin Potok, për të protestuar kundër pranisë së Policisë së Kosovës dhe kryetarëve shqiptarë të këtyre komunave.

Numri i tyre në mëngjes është më i vogël për shkak të motit me shi, ndërsa nëpër disa komuna punëtorët janë nënshkruar në librat e evidencës për praninë e tyre. Autoblindat e Policisë së Kosovës, të cilat ditë më parë ndryshuan lokacionin

dhe u vendosën prapa objekteve komunale, nuk kanë lëvizur dhe po qëndrojnë aty. Ushtarët e KFOR-it, ndonëse në numër shumë të vogël, vazhdojnë të qëndrojnë përreth ndërtesave të komunave.





# Njohësi i çështjeve të emergjencave: Institucionet përgjegjëse t'i rritin kapacitetet në rast të përmbytjeve të mundshme

EPOKA  
ERE

Faton DËRMAKU

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Tahir Ahmeti, njohës i çështjeve të emergjencave, njëherësh drejtor ekzekutiv i Qendrës Kërkimore për Politika të Sigurisë (SPRC), ka thënë se qytetarët duhet të informohen për mundësinë e vërshimeve në vend pas reshjeve të pandalshme të shiut. Ai ka thënë se institucionet përgjegjëse në Kosovë, si ato qendrore ashtu edhe ato lokale, varësisht prej përgjegjësisë që kanë, duhet t'i ngritin kapacitetet e tyre. "Gjatë periudhës së fundit në vendin tonë kemi të reshura thuajse të përditshme. Instituti Hidrometeorologjik i Kosovës ka paralajmëruar për ditët në vijim mundësinë e vërshimeve të shpejta në pjesë të caktuara të vendit. Vërshimet e shpejta përfshijnë territore të caktuara dhe kalojnë shpejt, kryesisht ndodhin në lumenjtë ose përroskat e vogla malore, por që mund të shkaktojnë dëme në toka bujqësore dhe ekonomi familjare dhe biznesore. Qytetarët duhet të jenë të informuar për mundësinë e

këtyre vërshimeve në mënyrë që të jenë të përgatitur dhe sadopak të përipiqen t'i zvogëlojnë dëmet e mundshme, ndërsa institucionet përgjegjëse në Kosovë, si ato qendrore ashtu edhe ato lokale, varësisht prej përgjegjësisë që kanë, duhet t'i ngritin kapacitetet e tyre për t'u dalë në ndihmë qytetarëve në rast të përmbytjeve të mundshme", ka theksuar Ahmeti.

## Ekipi i zjarrfikësve ndërhyr pas vërshimeve në fshatin Zabel të Ulët në Drenas

Pas reshjeve të dendura të shiut, në disa zona të komunës së Drenasit janë paraqitur vështirësi në kalimin e lirë të veturave. Kjo ka ndodhur sidomos në zonën e rrugës Komoran - Drenas, saktësisht në fshatin Zabel i Ulët.

Ekipi i zjarrfikësve i komunës së Drenasit ka dalë në vendin e ngjarjes, i cili me pajisjet dhe ekspertizë ishte në dispozicion të banorëve të prekur nga këto vërshime. Këto informacione janë dhënë nga Drejtoria për



Shërbime Publike dhe Emergjencë në komunën e Drenasit, drejtori i së cilës, Nexhmedin Gruda, gjendet në terren, ku po kryhen intervenimet e nevojshme nga

ekipet e zjarrfikësve. Siç bëhet me dije, vetëm në fshatin Zabel i Ulët janë realizuar tri intervenime. Drejtoria për Shërbime Publike dhe Emergjencë është duke

përcjell me vëmendje situatën e krijuar në gjithë territorin e komunës së Drenasit dhe aty ku është e nevojshme të ndërhyjë me të gjitha kapacitetet që ka në dispozicion.

## Kurti dhe Vitia vizituan Spitalin e Pediatriisë në QKUK



PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryeministri Albin Kurti, i shoqëruar edhe nga ministri i Shëndetësisë, Arben Vitia, u. d. drejtoresha e ShSKUK-së, Narqize Arenliu, drejtoresha e Klinikës së Radiologjisë në QKUK, dr. Shkëndije Nuza, kanë vizituar Spitalin e Pediatriisë në Qendrën Klinike Universitare të Kosovës, në të cilin është funksionalizuar rezonanca magnetike që do ta shtojë vëllimin e shërbimeve në sektorin publik. "Shërbimi publik shëndetësor po zgjeron gamën diagnostike duke decentralizuar shërbimet, ofruar sa më afër qytetarit në spitalet regjionale dhe eliminuar listat e pritjes për shërbimet diagnostikuese me anë të rezonancës magnetike, problem ky që e ka përcjellë shërbimin publik me vite të tëra. Pas funksionalizimit të MRI-së në


spitalin e Pejës muaj më parë, MRI-së në Spitalin e Pediatriisë këtë javë, pritet që edhe përgatitjet infrastrukturore për funksionalizimin e MRI-së në qytetin e Prizrenit të përfundojnë në vjeshtën e këtij viti", ka theksuar kryeministr Kurti. Ndërsa ministri Vitia ka shtuar se ky shërbim i ri do ta mundësojë teknologjinë më të fundit të ekzaminimit për qytetarët në sektorin publik. Në Klinikën e Radiologjisë gjatë ditës në secilin prej aparateve të rezonancës magnetike, mesatarisht realizohen 20 deri 24 raste në ditë. Me funksionalizimin e rezonancës magnetike, e cila do të shërbejë vetëm për fëmijët, ky numër do të shtohet në 35-40 ekzaminime në ditë. Aparatura radiologjike është donacion nga Fondacioni "Sheikha Fatima".

## PDK-ja fton Kurtin në interpelancë për rastin e ambasadorit Martin Berishaj

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës (PDK), Memli Krasniqi, e ka ftuar kryeministrin Albin Kurti në interpelancë për ambasadorin Martin Berishaj, i dyshuar për përfshirje në një skandal financiar në Slloveni. Lajmin

për thirrjen e Kurtit në interpelancë në Kuvendin e Kosovës e ka dhënë të hënën Abelard Tahiri, shef i grupit parlamentar i PDK-së. Sipas Tahirit, kryeministri Kurti duhet të japë sqarime për mosshkarkimin e Berishajt. "Sa i përket çështjes së Martin Berishajt ju njoftoj se kryetari

Memli Krasniqi ka bërë një kërkesë për interpelancë për kryeministrin lidhur me mosveprimin e tij që ta shkarkojë atë. Ju e dini se z. Berishaj është përfshirë në një mega-skandal financiar. Kryeministri Kurti është duke tentuar ta amnistojë atë", ka thënë Tahiri.





## Ministria e Infrastrukturës shpall fituesit e tenderit për zgjerimin e rrugës Prishtinë - Podujevë

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës ka shpallur fituesit e tenderit për zgjerimin e rrugës Prishtinë - Podujevë. Janë tri konzorciume private që kanë përfituar nga një lot të tenderit. Sipas njoftimit të Komisionit Rregullativ të Prokurimit Publik (KRPP), vlera totale e këtyre loteve është mbi 24 milionë euro. Për pjesën e parë fitues është shpallur grupi i operatorëve ekonomikë Pro & Co Group Sh.P.K. dhe

Levantina Ingenieria Y Construcion. Vlera e këtij loti në kontratë është rreth 6.5 milionë euro. Ndërsa pjesa e dytë është fituar nga konzorciumi i operatorëve ekonomikë 2A Group Sh.P.K. dhe Vega Sh.P.K., me vlerë rreth 8.5 milionë euro. Derisa pjesa e katërt, apo loti 3, është fituar nga grupi i operatorëve Agbes Konstruksion Sh.P.K, Arbotec Sh.P.K., GEO Construction Sh.P.K., Mineral L.L.C. dhe BM Group Sh.P.K. me seli nga Fieri i

Shqipërisë. Ministri i Infrastrukturës, Liburn Aliu, në dhjetor të vitit të kaluar ka thënë se kanë zgjidhur problemet me shpronësimet për rrugën Prishtinë - Besi - Podujevë. Aliu kishte sqaruar se i tërë segmenti do të jetë pesë lote, 16 kilometra nga Lluzhani deri në Bërnice do të jetë e ndarë në katër lote dhe se loti i pestë është përfundimi i rrugës nga Lluzhani deri në Podujevë, që përbën segmentin prej nëntë kilometrash.



## Pse bizneset po vazhdojnë t'i rritin çmimet?

NJU-JORK, 12 QERSHOR - Pas dy vjetësh rritje të çmimeve, ekonomistët ende nuk po mund të arrijnë dakord për atë që ka shkaktuar krizën më të madhe të inflacionit në botë. Fajtorët e zakonshëm të përmendur nga ekonomistët përfshijnë pengesat e zinxhirit të furnizimit të epokës së pandemisë, luftën në Ukrainë dhe politika të ndryshme ekonomike të ShBA-së, të tjerë thonë se kjo është për shkak të "lakmisë", do të thotë kompanitë i përdorin normat e larta të inflacionit si një justifikim për t'i rritur çmimet. Megjithatë, sipas gjetjeve paraprake të një studimi të Rezervës Federale të Nju-Jorkut, mund të ketë diçka tjetër në lojë, raporton CNN. Hulumtimi me 700 biznese në Nju-Jork, Atlanta dhe Cleveland zbuloi se fuqia e kërkesës së klientit tejkaloi të gjithë faktorët e tjerë që kompanitë peshojnë kur vendosin çmimet, duke përfshirë marzhet e qëndrueshme të fitimit dhe inflacionin e përgjithshëm. Kjo do të thotë që një biznes në thelb mund të vendosë çmime aq të larta sa të dojë për sa kohë që ato nuk janë aq të larta sa ta largojnë bazën e klientëve. Më shumë se 82 për qind e bizneseve të anketuara thanë se



kërkesa është faktorizuar në vendimet e tyre për çmimet, ndërsa vetëm 52 për qind e bizneseve thanë se marrin parasysh normën e përgjithshme të inflacionit kur vendosin çmimet.

Klientët janë trajnuar për ta toleruar rritjen e çmimeve, tha John Zhang, profesor i marketingut në Shkollën Wharton në Universitetin e Pensilvanisë. "Gjatë inflacionit ju e dini se rriten kostot për

kompanitë, kështu që ju bëheni më të hapur ndaj çmimeve më të larta", tha ai. Zhang thekson se miratimi i rritjes së çmimeve mund të nxisë çmime edhe më të larta në të ardhmen, një cikël që

mund të jetë i vështirë për t'u thyer.

Restoranti "Mac and cheese" i Mac në Manchester, New Hampshire, u përpoq t'i rriste çmimet pak për ta vazhduar inflacionin në vitin 2021, por kjo nuk ishte e mjaftueshme për ta mbuluar rritjen e kostos për biznesin, tha pronari Mark Murphy. Nga frika e reagimit të klientëve, restoranti pranoi marzhe më të vogla në vend që t'i rriste çmimet.

Kur biznesi më në fund rriti çmimet, Murphy tha se vendimi ishte "i dhimbshëm". Kompanitë shumëkombëshe, "Colgate, Procter & Gamble" dhe "PepsiCo", kanë rritur çmimet me përqindje dyshifrore gjatë vitit të kaluar, sipas raporteve të të ardhurave të tyre të tremujorit të parë, duke tejkaluar normën e inflacionit në ShBA. "Megjithatë, derisa Rezerva Federale rrit normat e interesit dhe ekonomia ngadalësohet, klientët së shpejti mund të jenë më pak të prirë të paguajnë për mallra dhe shërbime", tha Zhang.

Bizneset mund të jenë tashmë në harmoni me ndryshimin: Ata të anketuar nga FED i Nju-Jorkut thanë se presin presione më të ulëta të kostos dhe çmimeve në vitin e ardhshëm.

## OECD: Ekonomia botërore, rritje të kufizuar gjatë vitit të ardhshëm

PARIS, 12 QERSHOR - Rritja ekonomike botërore do të përmirësohet në mënyrë të moderuar gjatë vitit të ardhshëm, pasi do të ndihen ndikimet e plota të rritjes së normës së bankave qendrore. Sipas Organizatës për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ekonomik (OECD), ekonomia botërore do të rritet 2.7 për qind këtë vit, ndryshe nga parashikimi i mëparshëm prej 2.6-përqindësh. Rritja do të përshejtohej vetëm pak në vitin e ardhshëm, pra në 2.9 për qind. Banka Botërore përmendi

shtimin e ndikimit të rritjes së normave, pasi përmirësoi parashikimin për rritjen botërore këtë vit, në 2.1 për qind, por për vitin 2024 e uli atë në 2.4 për qind krahasuar me parashikimin e mëparshëm 2.7 për qind. OECD parashikoi që inflacioni në grupin e 20 ekonomive kryesore do të binte nga 7.8 për qind vitin e kaluar në 6.1 për qind këtë vit dhe 4.7 për qind në 2024. Zyrtarët e Rezervës Federale kanë shënuar një pauzë të mundshme në rritjen e normave të interesit, ndërsa Banka Qendrore Evropiane ka

treguar se ka të ngjarë të ketë rritje të mëtejshme në muajt e ardhshëm. Në perspektivën e OECD-së norma kryesore e interesit e Rezervës Federale të ShBA-së arriti kulmin në 5.25-5.5 %, me ulje "modeste" të normës në gjysmën e dytë të 2024-s. Në Eurozonë, OECD pret që BQE të vazhdojë t'i rrisë normat si kundërpërgjigje ndaj inflacionit bazë ende të lartë, me një kulm të parë në tremujorin e tretë. Organizata parashikoi që BQE-ja më pas do ta çonte normën në 4.25 për qind deri në fund të vitit 2024.





# Njeriu që ndryshoi politikën dhe Italinë

Silvio Berlusconi ndërroi jetë në spitalin San Raffaele në Milano. Lideri i Forza Italia dhe themeluesi i Mediaset ishte 86 vjeç. Berlusconi u kthye në San Raffaele të premtën e kaluar, pas një shtrimi të gjatë – 45 ditë – i cili përfundoi disa javë më parë, për shkak të pneumonisë dhe leucemisë mielomonocitare. Në mëngjes, vëllai i tij Paolo dhe fëmijët kishin shkuar me urgjencë në spital, ku tashmë ndodhej Marta Fascina. Më poshtë artikulli i Antonio Polito. Nëse do të duhej të bënim anatominë e një çasti, në jetën e jashtëzakonshme të Silvio Berlusconit, ndoshta duhet të zgjidhnim mbrëmjen e 8 nëntorit 2011.

Jo ditën kur hapi kantierin e tij të parë, në Brugherio, në vitin 1964, ose themeloi Fininvest, në 1975, duke i hapur rrugën një perandorie televizive dhe financiare që e bëri atë një nga njerëzit më të pasur në botë. As ditën kur doli në fushë, në rrugën e tij për të fituar tre zgjedhje e gjysmë dhe për të udhëhequr katër qeveri për nëntë vjet. As kohën kur zbriti me helikopter në fushën e Arenës për të inauguruar historinë epike të Milanit, i cili fitoi pesë Champions League dhe tetë Scudetto në tridhjetë e një vjet.

Jo. Berlusconi mori aq shumë nga ajo fuqi në jetën e tij, sa momenti i vërtetë magjik, momenti për t'u rrëfyer, është ai në të cilin ai e humbi atë.

Ja si ishin gjërat: Italia po shpërbëhej për shkak të tregjeve që sulmonin borxhin tonë publik. Merkel dhe Sarkozy duke u tallur me të në publik. Europa që kishte frikë të fundosej bashkë me Italinë. Gianfranco Fini kishte krijuar një parti dhe kishte kaluar në opozitë. Tetë deputetë, të gjithë ish «fidelissimi», e tradhetojnë Cavalieren në një votë vendimtare, duke bërë që ai të humbasë shumicën në Montecitorio.

Por ai dëshiron të rezistojë. Mos u dorëzo. Mos jep dorëheqjen si kryeministër. “Këtë duhet të bëjë Berlusconi”, i sugjerojnë të gjithë ata që e rrethojnë, të cilët kanë jetuar gjithmonë në dritën e reflektuar dhe duan ta mbajnë atë të ndezur. Por më pas vijnë dy telefonata. E para është nga Ennio Doris, mik dhe ish-partner në Mediolanum: “Silvio, nëse nuk jep dorëheqjen, Italia do të shembet”. E dyta është nga djali i tij Luigi, i cili punon në qytetin e Londrës: “Babi, nëse shembet Italia, do të shemben edhe kompanitë tona”.

Sepse Berlusconi ishte një fenomen: vullnet për pushtet, sigurisht, por edhe domosdoshmëri historike. Së bashku fryti i sëmundjes italiane dhe në të njëjtën kohë përpjekja e tij për të kuruar. Jo keqbërësi që pushton një popull sylesh me doza kuajsh shitblerjesh televizive, siç është përshkruar; por as shpëtimtari i atdheut që çliron vendin e tij nga kozakët e Occetto-s, i pari nga liderët e shumtë të së majtës që mundi. Përkundrazi, për mirë e për keq, themeluesi i një të



djathte të re dhe një politike të re, me ambicie liberale dhe tipare populiste, që bëri shkollë në botë dhe dominoi skenën italiane për njëzet vjet, edhe kur ishte në opozitë.

Që pastaj përfundoi me të, aq sa për të fituar sërish iu desh të ndryshonte lëkurën, seksin, moshën dhe të mishërohej tek Giorgia Meloni, antropologjikisht e kundërta e tij. Profesionistët e anti-Berlusconizmit e kanë akuzuar atë për çdo krim. Dhe është e vërtetë që kundër tij janë ngritur më shumë se njëzet procese gjyqësore, me akuzat të ndryshme, ndonjëherë veçanërisht shpifëse, si shfrytëzimi i prostitucionit të fëmijëve në personin e Ruby Rubacuorit, një nga pjesëmarrëset e shumta në sarabandën e vajzave që priste në vilat e tij; apo si dyshimi për bashkëpunim me mafian që çoi në dënim dhe burg një nga miqtë dhe bashkëlufëtarët e tij më të mëdhenj, Marcello Dell'Utrin; apo edhe akuzat se kishte komplotuar masakrat e 1993 për të përshpejtuar triumfin e tij politik.

Ai është shpallur i pafajshëm, ose ndryshe i parashkruar nga pothuajse të gjitha akuzat, edhe falë arteve zvarritëse të turmës së tij të avokatëve. Prandaj, nëse duhet besuar ligji, ai i gjyqtarëve dhe jo vetëm i prokurorëve, Berlusconi ka kryer vetëm një krim: mashtrimin tatimor, për të cilin u dënua me një dënim të formës së prerë. Kjo i kushtoi një mbrojtje të shpejtë nga Senati, shumica e të cilit nuk e humbi mundësinë dhe me një votim të hapur sanksionoi papajtueshmërinë e tij.

Natyrisht, ai nuk ishte aspak një shenj, përkundrazi: kishte veset e tij private dhe publike dhe dinte të

luante pisët. Ka nga ata që e qortuan deri në fund, pa mëshirë, si armiku i tij i përhershëm Carlo De Benedetti, i cili edhe kur kundërshtari i tij ishte në spital me Covid, i uroi ditëlindjen, por duke përsëritur se për të ishte gjithmonë “një mashtrues”.

Shumë njolla ia kishin errësuar jetën publike. Origjina e kapitalit me të cilin Berlusconi filloi biznesin si sipërmarrës është ende e mbuluar me mister. Përdorimi i shumicës parlamentare për të miratuar ligje ad personam për t'u mbrojtur nga gjyqet zëvendësoi premtimet për reformimin e sistemit gjyqësor që nuk u mbajtën kurrë. Dhe perandoria televizive, e lindur me një dredhi për të kapërcyer ndalimin, përhapjen e kasetave të regjistruara në një rrjet televiziv lokal, u legjitimua me një dekret ligjor nga Craxi, miku i tij dhe dëshmitari i dasmës së tij me Veronica Lario, i cili e shpëtoi atë nga sekuestrimi.

Megjithatë, si gjithmonë në jetën e tij, secila prej këtyre ngjarjeve ka kthesën e saj. Për shembull: kush mund ta mohojë se fundi i monopolit të televizionit publik ishte tashmë i pjekur, një faktor modernizimi që ka ndryshuar Italinë? Berlusconi e kapi mollën në mënyrë të paskrupullt dhe mori ndihmë nga ata që ishin më lart se ai në atë kohë. Por në këtë mënyrë, ashtu si pasuria e tij, ndryshoi edhe jeta e italianëve, veçanërisht atyre më të izoluarve, të moshuarve, të varfërve dhe më pak të arsimuarve, të cilët mundën të mbushnin mbrëmjet e tyre me quize të Mike Bongiorno-s dhe telenovela braziliane, për më tepër falas, pa tarifa. Herë pas here e majta ka goditur kokën në këtë cep: atë që

ajo e konsideronte të patolerueshme dhe të padurueshme, njerëzit e thjeshtë e konsideruan të admirueshme. Miti kaq amerikan i njeriut të bërë vetë joshi popullin, duke rrëzuar nga fronti të majtën. Mbi të gjitha, Berlusconi zbuloi “le grand bleu” të politikës italiane, detin blu të thellë të votuesve të moderuar, ose në çdo rast armiqësorë ndaj të majtës. Bilanci përfundimtar i Berlusconit politik nuk është i keq për shkak të të gjitha gjërave që ai ka kërcënuar të bëjë ose që kundërshtarët e tij e kanë akuzuar se ka bërë; por më tepër për atë që premtoi dhe nuk e bëri. Kryeministri më jetëgjatë në historinë e Republikës e la “revolucionin liberal” në letër, taksa më të ulëta dhe më shumë rritje, premtimi që e kishte sjellë në qeveri. Ai nuk arriti të ndryshojë kushtetutën, sepse reforma e tij u mposht plotësisht në referendum. Ai dështoi – as nuk u përpoq ndonjëherë – të ribënte sistemin gjyqësor italian në një kuptim më garantues dhe më pak të dominuar nga prokurorët, duke preferuar kabotazhin e vogël të ligjeve “ad personam”.

Ai asnjëherë nuk e ka pranuar as për së largu, idenë e ndërtimit të një pasardhësi, në të vërtetë duke i prerë kokat një nga një të gjithë “delfinëve” të mundshëm, dhe kështu me sa duket do të marrë përfundimisht me vete krijesën e tij, Forza Italia. E cila në vitet e fundit të rënies fizike dhe elektorale të Kavalierit, në fakt është shndërruar në një oborr mesjetar, ku fatet apo fatkeqësitë varen nga favoret e të fejuarës së fundit, ambicet e ndihmësit të fundit, manovrat e oborrtarit të fundit. Berlusconi kishte gjithçka


për të ndryshuar Italinë, konsensus, sukses, forcë, para, pushtet; dhe nuk ia doli.

Në moshën 86-vjeçare, ai madje shpësoi për një moment jo të shkurtër që të vuloste biografinë e tij të jashtëzakonshme duke e shndërruar atë në një legjendë, me zgjedhjen e tij në Quirinale. Thjesht fakti që ai e pa në ëndërr na tregoi gjithçka për muzgun e epokës së tij. Ai ka shumë alibi. Dhe jo vetëm në furinë kokëfortë të prokurorëve ndaj tij. Dy ngjarjet tragjike epokale që tronditën botën që në fillimet e qeverisjes së tij, sulmi ndaj Kullave Binjake në 2001 dhe kriza e subprimeve në 2008, sigurisht që frenuan ambicet e tij. Por kalimi i tij në historinë politike të Italisë ka lënë edhe gjurmë të pashlyeshme: për shembull bipolaritetin, një stinë e dominuar prej tij, dhe ndoshta jo rastësisht përfundoi menjëherë sapo u largua nga skena, për t'i dhënë hapësirë në vitet e fundit veseve të lashta italiane të transformizmit dhe mazhorancave që ndryshojnë si rrobat me ndërrimin e stinëve. As “mrekullia” e fundit nuk pati sukses.

Një herë Don Verzè, themeluesi i San Raffaeles në Milano, me të cilin ishte mik dhe dashamirë, zbuloi se i kishte kërkuar “të jetonte deri në 150 vjet për ta rregulluar Italinë”. Ai po llogariste në përparimin e shkencës, ose ndoshta po bënte shaka me të drejtë e tij për pavdekësi. Ai vdiq në të njëjtin spital në moshën 86-vjeçare, vetëm dy më shumë se mesatarja kombëtare. Duke vërtetuar natyrën e tij si një “italian tipik”, si një autobiografi e kombit, e asaj Italie për të cilën në një incipit të famshëm thoshte “është vendi që dua”. / Corriere della sera – bota.al



**EURO GLASS**  
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON  
Enveri  
Adr: Fushë Kosovë  
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336  
E-mail: euro.glass@live.com



## FC Prishtina 01, kampione e Kosovës në Futsall

PRISHTINË, 12 QERSHOR - FC Prishtina është kampione e re e Kosovës në Futsall. Skuadra kryeqytetase në ndeshjen e tretë dhe përcaktuese të serisë finale të "play-off"-it arriti të

triumfojë me rezultat bindës 4:1, duke e mbyllur serinë e ndeshjeve finale 2:1. FC Prishtina 01 pas Kupës së Kosovës u kurorëzua edhe me titullin e kampiones, duke e

përmbyllur një sezon fantastik. Në fund, presidenti i FFK-së, Agim Ademi, ia dorëzoi trofeun e kampionit kapitenit Shefki Kameri, derisa medaljet për ekipin

kampion i dhanë nënkryetari Bakir Burri, drejtori për Sport në komunën e Prishtinës, Granit Rugova dhe kryetari i Komisionit të Futsallit, Hysni Gjinovci.



## 'Dardanët' zhvilluan lojë kontrolluese

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Përfaqësuesja e Kosovës në futboll, në përpjekje për t'u përgatitur sa më mirë për dy ndeshjet kualifikuese për "Euro 2024" kundër Rumanisë dhe Bjellorusisë, ka vazhduar punën me entuziazëm në seancat stërvitore. Në seancën e sotme, "Dardanët" e kanë zhvilluar një lojë kontrolluese. Grupi i futbollistëve është ndarë në dy ekipe. Përkundër reshjeve të vazhdueshme të shiut dhe fushës së rrëshqitshme, futbollistët kanë treguar përkushtim maksimal dhe kanë shfaqur formë të mirë. Sipas njoftimit të Federatës së

Futbollit të Kosovës, përzgjedhësi Alain Giresse e ka vëzhguar paraqitjen dhe lëvizjet e futbollistëve. "Përzgjedhësi Alain Giresse e ka vëzhguar me vëmendje paraqitjen dhe lëvizjet e futbollistëve, teksa me stafin do ta bëjë edhe videoanalizën e performancës së tyre në mënyrë që t'ua japë udhëzimet e nevojshme për ndeshjen kundër Rumanisë. Nga afër këtë seancë përgatitore e ka ndjekur edhe presidenti Agim Ademi, duke treguar kështu mbështetje dhe inkurajim për ekipin para dy sfidave tejet të rëndësishme", thuhet në njoftimin e FFK-së.




Stërvitja e radhës e Kosovës është paraparë të zhvillohet të martën në orën 10:30 në Kampin Nacional në Hajvali. Në prag të dy ndeshjeve të cilat vlerësohen të rëndësishme për

fatim e mëtejme të këtij cikli kualifikues, të gjithë që janë të përfshirë në kombëtaren dardane janë duke punuar me vendosmëri dhe përkushtim për të arritur sukses.

## Frashëri largohet nga Ballkani

Suharekë, 12 qershor - Stivi Frashëri nuk është më pjesë e Ballkanit. Portieri shqiptar i ka ndarë rrugët me klubin nga Suhareka pas suksesit të jashtëzakonshëm që e patën bashkërisht. Therandasit u shpallën kampione të dyfishtë të Kosovës, ndërsa në portë e kishin gardianin e tyre të sigurt. "Me anë të këtij postimi ju njoftojmë se pas dy sezoneve bashkë, FC Ballkani ka ndarë rrugët me portierin Stivi Frashëri. Klubi e falënderon gardianin, pasi falë edhe kontributit të tij të madh, kemi arritur sukseset tona historike. Po ashtu, i urojmë shumë suksese në vazhdim të karrierës", thuhet në njoftimin e Ballkanit.



## Nis 'Java Olimpikë', shumë aktivitete sportive do të mbahen në gjithë Kosovën

PRISHTINË, 12 QERSHOR - Nga dita e hënë deri më 16 qershor në për të gjitha komunat e Kosovës do të zhvillohen aktivitete të ndryshme sportive në kuadër të "Javës Olimpikë" që organizohet nga Komitetit Olimpik i Kosovës. Përfshirja e sa më shumë të rinjve dhe të të rriturve në aktivitete sportive është qëllimi kryesor i këtij aktiviteti. Presidenti i KOK-ut, Ismet Krasniqi, ka thënë se motoja kryesore e këtij aktiviteti është marja me sport sa më shumë që është e mundur. Ndërsa kryetari i Federatës Atletike të Kosovës, Halil Sylejmani, njëherësh kryetar i komisionit për organizimin e Javës Olimpikë, derisa zbuloi agjendën e kësaj jave, theksoi se të gjitha komunat e Kosovës do të kenë organizime të ndryshme sportive. "Më 13 qershor është paraparë të mbahet tryeza e sportit në



bashkëpunim mes Ministrisë për Kulturë, Rinisë dhe Sport dhe Komitetit Olimpik të Kosovës, pastaj do të vizitohen kopshtet publike dhe private ku do të promovohen vlerat olimpikë. Të njëjtën ditë do të zhvillohen aktivitete në Gjilan, Malishevë, Han i Elezit, Drenas dhe Fushë-Kosovë. Më 14 qershor Federata e Sportit Universitar e Kosovës do të organizojë aktivitete të

ndryshme sportive, kurse komunat që do të kenë aktivitete janë Vushtrria, Skenderaj, Peja, Istogu, Klina, Deçani dhe Juniku. Më 15 qershor do të mbahet turneu i futbollit i cili organizohet në stadiumin e Tokbahçës me pjesëmarrjen e ekipeve kryesive nga institucionet sportive. Në të njëjtën ditë, komuna e Podujevës, e Vitisë, e Kamenicës, e Obiliqit, e Gjakovës dhe e

Rahovecit do të organizojnë aktivitete me fëmijët. Të premtën do ta shënojmë Ditën Olimpikë. Me këtë rast do të mbahet edhe prezantimi i ekipit të Kosovës për Lojërat Evropiane 'Krakov 2023'. Po ashtu, do të organizohen aktivitete në komunën e Prishtinës, Mitrovicës, Prizrenit, Suharekës, Ferizajt dhe Lipjanit", ka thënë Sylejmani. Agron Dubovci, sekretar i Federatës së Sportit Shkollor, deklaroi se fokusi kryesor do të jetë të fëmijët para të cilëve gjatë kësaj jave do të prezantohen fituesit e medaljeve olimpikë në mënyrë që edhe ata të frymëzohen që të sjellin medalje të nivelit të lartë në Kosovë në të ardhmen. Aktiviteti kryesor do të zhvillohet të premtën, më 16 qershor, në "Ditën Olimpikë", ku edhe do të bëhet prezantimi i ekipit të Kosovës për Lojërat Evropiane "Krakov 2023".

## West Hami sërish interesohet për Brojën

LONDËR, 12 QERSHOR - Skuadra e Premierligës, West Ham United, është duke planifikuar që sërish ta provojë transferimin e mundshëm të sulmuesit të Chelseat dhe kombëtares

shqiptare, Armando Broja. "Bomberi" kuqezi aktualisht është duke u rikuperuar nga një lëndim që pasoi me një operacion në gjurin e tij. Broja duket një perspektivë e mirë dhe

ka qenë në shënjestër të David Moyes më parë. Drejtuesit e West Hamit ishin të revoltuar me Chelsean pasi ata nuk e lanë që Broja të largohej dhe kështu "Hammers" u detyrua të

transferojë sulmuesin italian, Scamacca. Për këtë të fundit, zërat e largimit sa vijnë dhe shpeshohen, kështu që West Hami dëshiron të futet në garë përsëri për Armando Brojën.





## Milani dhe futbolli italian në zi, ndahet nga jeta Silvio Berlusconi

MILANO, 12 QERSHOR - Njoftimi erdhi nga spitali "San Raffaele", ku ai ishte shtruar që nga e premtja për t'iu nënshtruar "testeve të planifikuara" në lidhje me leukeminë kronike mielomonocitare, nga e cila vuan prej disa kohësh: Silvio Berlusconi ka ndërruar jetë në

moshën 86-vjeçare. Rreth orës 10:00 në spital mbërritën vëllai i tij Paolo, fëmijët e tij Marina, Barbara dhe Eleonora. Presidenti historik i Milanit, të cilin e ngjiti në krye të botës, pasi e shpëtoi nga falimentimi, Berlusconi, dy vjet më parë ishte bërë numri një i Monzas,

skadër të cilën e ngjiti në Serinë A. Ai ishte kryeministër i Italisë, pasi themeloi "Forza Italia", duke fituar zgjedhjet në vitin 1994, pas një jete si sipërmarrës që filloi me "Edilnord" dhe më pas krijoi "Mediaset", një kompani që iu dha punë miliona italianëve.

Me të në krye, Milani fitoi 8 tituj të Serisë A, një Kupë Itale, 7 Superkupa Itale, 5 Liga Kampionësh, 2 Kupa Ndërkontinentale, 5 Superkupa Evropiane dhe një Botëror për Klube. Pra, fitoi gjithsej 29 trofe zyrtarë për 31 vjet.



## Seferi: Jam gati për Kombëtaren, ta marrim maksimumin

TIANË, 12 QERSHOR - Taulant Seferi, në konferencë për medie në prag të ndeshjes që Shqipëria luan ndaj Moldavisë, tha se ka besim tek ekipi teksa u ndal edhe te kampionati ukrainas gjatë luftës. "Kam pasur një sezon shumë të mirë dhe jam shumë i kënaqur. Jam 100 % i përgatitur dhe shumë i lumtur që jam këtu. Kushdo që vjen ka vullnetin të japë 100 %. Unë jam gati, por të shohim. Në ditët e sotme nuk janë emrat ata që bëjnë, por çdo kundërshtar është i vështirë. Duhet përqendrim 100 % sepse mund të kemi probleme, prandaj duhet ta bëjmë maksimumin në ndeshje dhe në stërvitje", ka thënë Seferi, i cili ka folur edhe për trajnerin kuqezi: "Herën e parë kam thënë që trajneri ka sjellë harmoni dhe pozitivitet. Të gjithë jemi bashkë dhe e shoh se tani jemi të lumtur shumë. Nuk kemi pasur shumë kohë me Poloninë, por bëmë një ndeshje pozitive. Këto ditë po punojmë mirë. Jemi një grup shumë i mirë dhe shumë pozitiv".



Në lidhje me kundërshtarin e radhës, Moldavinë, Seferi ka deklaruar se është një kundërshtar e vështirë: "Ne shohim punën tonë dhe atë që do trajneri. Çdo ditë e analizojmë kundërshtarin dhe e dimë se çfarë duhet të bëjmë në fushë dhe çfarë kërkon trajneri. Besoj se me maksimumin tonë mund t'ia dalim". "Forma e sulmuesve? E kam thënë që çdo gjë është pozitive si në hotel ashtu edhe stërvitje. Trajneri ka idetë e tij dhe ai e di se me kë fillon. Ne kemi

për detyrë ta bëjmë maksimumin dhe ai vendos. Siç e dimë, është fundi i sezonit dhe te Kombëtarja duhet përqendrim. Nuk duhet të shpërqendrohemi, por të kemi kujdes. 6 pikë? Ne jemi të fokusuar te Moldavia dhe duhet ta kalojmë me 3 pikë. Më pas do të shohim të dytën dhe normal që provojmë më të mirën dhe shpresoj të fillojmë me pozitivitet", ka deklaruar Seferi, i cili i ka ftuar tifozët të vijnë për t'i përkrahur sepse Shqipëria atëherë është më e fortë dhe më e motivuar.

## Guardiola: Në Ligën e Kampionëve duhet të kesh fat

MANCHESTER, 12 QERSHOR - Pas pritjes së gjatë, Pep Guardiola më në fund erdhi dhe fitoi Ligën e Kampionëve. Pas 12 vjetësh, trajneri spanjoll e ngjiti lart trofeun e çmueshëm evropian, duke ia siguruar Manchester City trofeun e parë në histori. Në një intervistë dhënë për "Ole", ish-trajneri i Barcelonës dhe i Bayern Munichut i shpjegoi ndjenjat e tij. "Si jam ndier? Nuk e di, asgjë speciale. Kam menduar të flija, madje as nuk kam pirë shumë gjatë festimeve, e kisha ndërmend të pushoja. E vërteta është se jam i lumtur për shumë gjëra që më vijnë në mend. Liga e Kampionëve është një kompeticion mjaft i vështirë për t'iu fituar, e dimë të gjithë, dhe është diçka që ndodh rrallë në jetë. Kështu që, ta fitosh përsëri dhe në këtë klub që më ka pritur kështu aq mirë, është diçka mjaft e bukur", u shpreh Guardiola. "Sot jemi mjaft të lumtur, por në fund kemi mundur të barazonim apo të humbim. Në fund, në sportin e këtyre niveleve të



larta si këto, detajet e bëjnë diferencën. Dhe, detaji ishte dëshira për të fituar, të cilën e kishim të gjithë ne. Jo vetëm lojtarët, por i tërë klubi dhe krejt personat. Ishte gjithmonë e vështirë për ne që ta realizonim këtë ëndërr dhe në fund ia dolëm. Por, kjo nuk na ndryshon, nuk më ndryshon as mua", vazhdoi trajneri i suksesshëm spanjoll. "Sot jemi mjaft të lumtur dhe të kënaqur, por e di se në të kaluarën kemi mundur të fitonim dhe këtë radhë kemi

mundur të humbim. Në ligë fiton kush është më i miri, por në Champions duhet të kesh edhe fat, duhet të jetë gjithçka e shkruar. Mos ma kërkon përse, por janë mijëra detaje në një sezon që të sjellin te mendimi se 'këtë vit na takon ne'. Dhe, kështu ishte. Kjo Ligë e Kampionëve ua jep kuptimin pesë titujve të Premierligës që i kemi fituar", ka përfunduar Guardiola. Ai e kishte fituar Ligën e Kampionëve dy herë me Barcelonën, ndërsa ky ishte trofeu i tretë për të.

### SHKURT

#### Kapra: Dua edhe titullin e tretë me Ballkanin

Albin Kapra ka vendosur ta vazhdojë karrierën me Ballkanin. Ai së fundi ka rinovuar kontratën me klubin nga Suhareka, duke nënshkruar edhe për tri vite të tjera. Pas rinovimit, Kapra i ka falënderuar drejtuesit e kampionit të Kosovës për besimin e dhënë, ndërsa ka shprehur qartazi synimet e tij me këtë skuadër. Suksesi sa më i madh në garat evropiane si dhe titulli i tretë i kampionit radhazi janë qëllimet kryesore të futbollistit. "Shpresojmë që dhurata jonë për klubin të jetë titulli i tretë radhazi dhe vazhdimi i suksesit në Evropë me të njëjtin stabilitet si në sezonin e kaluar", ka shkruar Kapra në "Facebook".

#### Verstappen: Alonso është pilot më i mirë se Hamiltoni

Piloti holandez Max Verstappen tregohet i ashpër me Lewis Hamiltonin kur bie fjala për të zgjedhur me britanikut dhe Fernando Alonso. Piloti i Red Bullit nuk ka dyshime se cili mes tyre është më i miri, duke zgjedhur pilotin spanjoll, veteranin e Formulës 1. "Më pëlqen të mendoj se të kesh një aftësi shtesë është një avantazh në Formula 1. Vetëm pak pilotë e kanë një gjë të tillë dhe për mua një ndër ta është padyshim Fernando Alonso. E ndiej këtë gjë për mënyrën se si i jep makinës, mënyrën se si merret me gjërat më të vogla. Fernando piloton në limite, ndërkohë që mendon edhe për gjëra të tjera", ka thënë Verstappen. Duke folur për Hamiltonin, piloti holandez shton: "Nuk mendoj se Lewisi e ka këtë karakteristikë si Fernando. Alonso dallohet në këtë drejtim dhe për mua është një pilot më i mirë. Ndoshta njerëzit do të më urrejnë për këtë që them, por unë bëj një vlerësim edhe si koleg që i shoh në pistë".

#### Mbappe i lirë më 2024, Reali i 'fërkon' duart

Më 21 maj 2022 Paris Saint-Germain njoftoi për rinovimin e kontratës së Kylian Mbappes deri më 30 qershor 2025, por situata mund të ndryshojë rrënjësisht. "L'Equipe" raporton se sulmuesi i kombëtares franceze ka nënshkruar për dy sezone, pra deri në vitin 2024, me opsion edhe një vit që do të ushtrohej vetëm me pëlqimin e lojtarit. Kjo e ndryshon plotësisht situatën, pasi Real Madridi mund të rikthehet në garë për të nënshkruar me yllin francez brenda një kohe të shkurtër. Duke filluar nga vera e ardhshme, PSG-ja do ta gjente veten në të njëjtën situatë si më 2021, me një lojtar që mund të lihej i lirë më 2024.

#### Asllani: Krenar që jam zikaltër

Nëpërmjet rrjeteve sociale, mesfushori shqiptar i Interit, Kristjan Asllani, ka reaguar pas humbjes të së shtunës në finalen e Ligës së Kampionëve kundër Manchester Cityt. "Një vit që kë ka dhuruar emocione që nuk do t'i harroj kurrë. Faleminderit të gjithëve që më keni shoqëruar në këtë udhëtim të jashtëzakonshëm! Krenar që jam zikaltër. Faleminderit djema!", ka shkruar Asllani.

## De Bruyne u lëndua në finale, pritet të mungojë gjatë

Kevin De Bruyne pritet të mungojë për një kohë të gjatë pas dëmtimit të pësuar në finale kundër Interit. Sipas

"Sportmediaset", mesfushori belg rrezikon të qëndrojë jashtë fushave të blerta për tre muaj pas dëmtimit që pësoi në kofshë.

Megjithatë, kjo pritet të konfirmohet në orët në vijim. Në rast se dëmtimi i De Bruynë zgjat për tre muaj, 31-vjeçari me

shumë gjasë do t'i humbasë dy finale. Një ndaj Arsenalit në Community Shield dhe Superkupën e Evropës ndaj

Sevillas. Këtë sezon në 32 paraqitje në Premierë Ligë, belgu ka qenë fantastik me 7 gola të shënuara dhe 18 asistime.





Republika e Kosovës  
Republika Kosova - Republic of Kosovo  
Qeveria - Vlada - Government

Trepça Shoqëri Aksionare  
Trepça Deonitarsko Društvo / Trepça Joint Stock Company



Duke u bazuar në Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021, divizioni i shitjes dhe qirasë me datën 12.06.2023 bënë shpallje publike:

### NJOFTIM PËR DHËNE KONTRATËS: T-23-08

Qëllimi i ofertës: Dhënie me qira e një pjese të Parcela me Numër: P-71208128-01090-15. në njësisë biznesore Industria Kimike.

Kriteret e Dhënies: Çmimi më i lartë

Numri i ofertave të pranuar: 1 (një)

### ME KONTRATË SHPËRBLEHET

Loti 1 Çmimi 1,300.00 €/Muaj/Me TVSH – TehnoBurimi DD

Kontratrat janë paraparë të nënshkruhet me datën 15.05.2023<sup>1</sup> ora 10:00

#### AUTORITETIT KONTRAKTUES (AK)

|                                  |                     |                               |
|----------------------------------|---------------------|-------------------------------|
| Emri zyrtarë: Trepça sh.a.       |                     |                               |
| Adresa postare: Parku industrial |                     |                               |
| Qyteti: Mitrovicë                | Kodi postarë: 40000 | Shteti: Kosovë                |
| Kontakti: Burim HAJDINI          |                     | Telefoni: +383 (0) 28 538 050 |
| Email: hajdini_b@hotmail.com     |                     | Faksi: +383 (0) 28 539 202    |
| www.trepccorporation.com         |                     |                               |

Çdo palë e interesuar mund të bëjë ankesë pranë Autoritetit Kontraktues, në bazë të nenit 14 të Rregulloren për dhënie me qira të pronës së paluajtshme të Trepçës Sh.A. me numër protokoll 119 date 11.01.2021.

<sup>1</sup> Nëse Kontrata nuk nënshkruhet deri me datën 22.06.2023 ky njoftim nuk do ketë efekte juridike.



## Gjej PUNË

- Lajme nga tregu i punës
- Shërbime shkrimi

Gjej Punë ofron shërbime drejtë përgaditjes së:

- CV-së
- Letrën Motivuese
- Parapregaditje për intervistë



facebook



[www.facebook.com/gjeipuneshpejte](http://www.facebook.com/gjeipuneshpejte)

## RESTAURANT

# SWISS

## TAVERNA

Tel: +377 45 400 156

+386 49 848 553

PRISHTINË

### >> SHPALLJE TË VOGLA <<

- Te Arbeni SH.P.K shpall te pavlefshme certifikatën e TVSH-se si dhe certifikatën e biznesit me nr: 811421677.

- Aysel Kirkul shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIII shfmu " Emin Duraku " Prizren.

- Muhamet Zherka shpall te pavlefshme diplomën shme " Ymer Prizreni " Prizren.

- Leon Kuqanaj shpall te pavlefshme dëftesat e shkollës fillore "FAZLI GRAJQEFCI".

- Albana Peci shpall te pavlefshme dëftesën e klasës 10 te shkollës se mesme "Hasan Prishtina".

- "Auto Geti 1" SH.P.K. shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së.

- Kosovare Imer Hasanaj shpall të pavlefshme Diplomën e Fakultetit të Edukimit në UP "Hasan Prishtina" Prishtinë, Bachelor për shkak të gabimit teknik Kimi –Fizik duhet të jetë Fizik-Kimi me nr. 1243.

- Ilir Sadrijaj nga Gramaçeli, komuna e Deçanit shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 10.11 të sh.m. Ekonomike "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" instalues i ujit dhe kanalizimit Gjakovë.

- Petrit Thaçi nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e SH.M. Teknike "Nexhmedin Nixha" Makinerisë Gjakovë.

- Valon Vala nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 10 të SH.M.E. "Kadri Kusari" Gjakovë.

- Joni Bajraj nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesën e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Irfan Gerbani shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën Q K "11 Marsi" Prizren.

- Edin Bicaku shpall te pavlefshme 3 dëftesa dhe diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- Visar Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - IV shfmu "Bajram Curri" Krushë e Madhe.

- Enver Ramadani shpall te pavlefshme dëftesat e kl I - VIIIshfmu "Fadil Hisari" Prizren.

- CelebicEsef shpall te pavlefshme diplomën QK "11 Marsi" Prizren.

- XhelalFerizi shpall te pavlefshme certifikatën QK "11 Marsi" Prizren.

- Valmir Kadrija shpall të pavlefshme diplomën e shkollës së mesme "Hivzi Sylejmani" Fushë Kosovë.

- Veton Aliu, shpall te pavlefshme dëftesën e 11 klase te shkollës se mesme "ARKITEKT SINANI".

- Bleona Binaku, shpall te pavlefshme diplomën e shkollës se mesme "FRANG BARDHI".

- Merlind Qorri nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. III të sh.m. Teknike "Nexhmedin Nixha" Gjakovë.

- Remzi Kida nga Gjakova shpall të pavlefshme dëftesat e kl. 11 të Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Flamur Godeni nga Gjakova shpall të pavlefshme diplomën e Gjimnazit "Hajdar Dushi" Gjakovë.

- Besart Myftari B.I. shpall të pavlefshme certifikatën e biznesit me nrb 811937046.

- Lëshoj lokalit me qira. Lokali është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokali gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit:049-392-275

- Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçanët me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

- Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.





# ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

## Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comercio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol C.JSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

